ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministria e Financave**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **201-26-8482-5-5-8**

Sa i përket tenderit për **Furnizimi dhe montimi i Inventarit për nevojat e MF-së LLOT 1.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

GALANTERIA" SH.P.K_____
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)
Rr. "Ismail Qemali"_____
(Adresa)
Podujeve_____
(Vendi) *(Kodi postar)*
049 945 949_____ _____
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*
Nderim Ymeri_____
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
galanteriashpk@gmail.com_____
(Adresa elektronike)
09.11.2026_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

GALANTERIA SHPK PODUJEVË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)
_____
(Adresa e plotë)
_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*
_____
(Adresa elektronike)
_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontrate – 02.10.2026
- Hapja e ofertave - 12.10.2026
- Njoftimi mbivendmine AK-se - 21.10.2026,
- Kerkesa për ri shqyrtim - 26.10.2026
- Vendimi i AK mbi refuzimin – 29.10.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

- Hapja e ofertave - 12.10.2026

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Neve si OE me datën 26.10.2026, brenda afatit ligjore te parapare me LPP, kemi paraqitur kerkese për ri shqyrtim tek AK – MF, dhe i njejti AK, me datën 29.10.2026, nxjerre vendmim dhe refuzon kerkesen tone si te pa bazuar ani pse ne si kompani kemi paraqit prova dhe argumente te cialt konfirmojne dhe konsumojnë shkelje ligjore.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji për Prokurim Publik nr. 04/L-042, i amandamentuar me ligje tjera

- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit
- Neni 28 Specifikimet teknike
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

OE ankues “Galanteria” shpk si pale ne procedure, me interes juridik dhe material, pas pranimit te vendimit te AK-se – formularit B58, ka kerkuar qasje ne dokumente publike dhe brenda afatit ligjore përkatësisht me datën 26.10.2026, ka paraqitur kerkese për ri shqyrtim te vendimit te AK-se, me kerkese për ri vlerësim te ofertave duke prezantuar prova dhe dëshmi konkrete te cilat konfirmojne veprimet kundërligjore dhe abuzimin me dispozita ligjore por qe AK, me vendimin e saje te datës 29.10.2026, ka refuzuar kerkesen tone si te pa bazuar, prandaj ne kuptim te nenit 109 te LPP-se paraqesim kundër argumentet tona si me poshte:

Pretendmi ankimore 1:

AK – MF, ne dosjes të tenderit, gjegjesisht ne aneksin 1, te pozicionit 2, për lotin 1, ka përcaktuar:

- *"Baza: Bazë me 5 këmbë, me diametër minimal 65 cm. Material: alumin i lustruar ose material ekuivalent në qëndrueshmëri dhe cilësi."*

AK – Ministria e Financave në letrën standarde si arsyetim te eleminimit ndaj ofertës sonë ka potencuar se:

- *"Materiali i këmbëve të karrikës: Këmbët janë prej plastike dhe nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga A.K !"*

Ky arsyetim i eleminimit te ofertës sonë tregon qarte për favorizim te kompanis se rekomanduar për kontrate ne këtë lot, perkatesisht diskriminim te kompanis sonë, pasi qe vetë dosja e tenderit e lejon tekstualisht materialin ekuivalent: "ose material ekuivalent në qëndrueshmëri dhe cilësi".

Ne si OE, me oferte kemi ofruar karrige me bazë polipropileni të përforcuar apo plastikë

PP, me densitet të lartë konstruktiv, i cili në industrinë bashkëkohore ergonomike të zyrave njihet si material ekuivalent me rezistencë të lartë ndaj ngarkesave mekanike.
Qellimi dashakeq apo vleresimi i njejaneshem i AK-se si tërësi dhe komisionit vleresues te ofertave ne veqanti shperfaqet kur, ndaj kompanis se rekomanduar për dhënie te kontratës "IBM" SH.P.K, pikerisht për këtë produket apo për kembet e karriges se kerkuar ne lotin 1, nuk ka fare alumin te lustruar, por metal i kromuar dhe ne faqen 7 dhe 9 të Vendimit Nr. 23/2026, AK – MF, vet deklaron shprehimisht se:

- *"Sa i përket materialit të bazës, ajo është prej metali të kromuar, ndërsa AK e ka vlerësuar këtë material si ekuivalent me materialin e kërkuar në specifikimin teknik."*

Pra vet AK, e pohon me vendimin e saje se edhe produkti i ofruar nga OE i propozuar nuk e pletoson specifiken teknike te përcaktuar ne aneksin 1 dhe si ka mundësi që për IBM SH.P.K. parimi i ekuivalencës nga alumini në metal të kromuar te njihet nga AK, ndërsa për komanin tone "Galanteria" SH.P.K, "ekuivalenca" injorohet tërësisht dhe shërben si bazë eliminimi i ofertës sonë ! Kjo përbën trajtim të pastër diskriminues dhe shkele direkte dispozitat e nenit 7 të LPP-së.

Pretendimi ankimore 2.

Arsyetimi tjetër i eleminimit lidhur me materialin e mbështetëses së kokës -qafës, ku ne pozicionin 2, te aneksit 1 lidhur me lotin 1, eshte percaktuar kjarte: "Pjesa te qafa e ndarë dhe me material me rrjetë", ndërsa ne arsyetim te eleminimit njëanshëm potencohet se "Mostra e karriges nuk e ka mbështetësen e kokës me rrjetë, por me plastikë PP" !

Neve si OE, se bashku me oferte si moster kemi prezantuar karrigen ashtu siç është kerkuar nga AK.



Prova e sipër prezantuar dhe e dorezuar ne cilesi te mostres tek AK – MF, konfirmon sakt se mbeshtetsja e kokes është rrjete ashtu siq është kerkuar nga AK, tek aneksi 1 i dosjes se tenderit.

Pra nga fotografia duket qartë se sipërfaqja e kontaktit anatomik është 100% material rrjetë, ndërsa plastika PP përbën kornizën mbajtëse mekanike apo lidhëse me trupin e karriges dhe nuk ekziston karrige zyre në treg ku rrjeta të qëndrojë në ajër pa kornizë mbajtëse polimerike !

AK ka shtrembëruar qëllimisht natyrën e materialit për të krijuar një alibi për te eliminuar kompanin tone dhe se këto veprime po te raportohen ne ndonje instance apo te kerkohet ndonje ekzaminim laboratorik, zyrtaret pergjejges te AK-se do ti veje para pergjegjesise ligjore për eleminim te njeaneshem te kompanis sonë.

Trajtimin jo i barabartë dhe abuzimi me nenin 7 dhe 59 të LPP-së, apo konfirmimi për vlerësim me standarde te dyfishta dhe qasje tendencioze me qëllim eliminimin e kompanis sonë, konfirmohet edhe përmes provës:

- **Letra Standarde për Tenderuesin e Eliminuar me nr. prokurimi 201-26-6269-5-5-8 e datës 02.09.2026,** aktivitet i zhvilluar i njëjti AK dhe atë vetëm një muaj më parë ku për po të njëjtin produkt: *"Karrigë lëvizëse me mbështetëse të lartë, për zyre-ergonomike – Pozicioni 2", prap na* ka eliminuar ekskluzivisht për shkak të llojit të shtofit të ulëses *"ofertuan shtof mikrofiber pa elemente të ajrosjes"*, duke mos konstatuar asnjë mospërputhje, asnjë vërejtje dhe asnjë pretendim për materialin e këmbëve të karriges apo materialin e mbështetëses së kokës/qafës.
- Përkundër kësaje ne këtë procedure te cilen kemi paraqit ankese neve kemi dorezuar plotësisht konform mbi shtofin me vrima ajrosëse, i njëjti komision i AK-së krejt papritur shpik si shkaqe eliminimi pikërisht këmbët dhe mbështetësen e kokës, të cilat në shtator 2026 ishin të pranueshme quditerisht !

Pretendmi ankimore 3:

AK – MF, ka rekomanduar për dhënie te kontratës kompani totalisht te pa pergjejgshme kundrejt kerkesave kualifikuese dhe specifikave teknike te detyrueshme jo vetëm ne llotin 1 por edhe ne lotet tjera ku tani me veqe se janë lidhur kontrata ani pse oferta e tyre ka qene e pa pergjegjshme ne tërësi dhe ne te gjitha aspektet.

Tendenca dhe qellimi për lidhje te kontratës me kompanine perkatese konfirmohet me manipulimin e matjeve.

Gjatë realizimit të qasjes në dokumente zyrtare dhe mostra me datë 23.10.2026, OE ankues, ka realizuar matje të mostrës së OE IBM SH.P.K, ku eshte konstatuar se:
- 1. Gjerësia e mbështetëses së shpinës është vetëm 45.5–46 cm dhe si e tille nuk e ploteson specifiken teknike prej prej 50 cm

- 2. Baza konstruktive apo "ylli" nuk arrin diametrin minimal prej 65 cm dhe
- 3. Matjet e pasqyruara nga vetë AK në vendimin refuzues nr. 23/2026, janë bërë në mënyrë të manipuluar dhe nën kënd të pjerrët për të mbuluar devijimet thelbësore teknike të këtij produkti dhe se te gjitha këto fakte vërtetohen nga realizomi i fotografive të realizuara në ambientet e Autoritetit Kontraktues, të cilat i bashkëngjiten kësaj ankese si dëshmi.

Pretendmi ankimor 4.

OE ankues “Galanteria” SH.P.K, ka paraqitur ofertë te pergjegjeshme dhe konform kërkesave te aneksit 1, dhe se ligji për prokurim publik ne fuqi dhe aktet tjera nënligjore për tipin e kontraktave te tilal apo te natyres se fuqinizimit e obligon secilin AK, perkates qe pas lidhjes se kontratës te krijohet komisioni për pranimin e produkteve dhe se nese AK, kerkon konfigurim specifik të këmbëve apo detajeve të tjera teknike, OE fitues ka obligim kontraktual të dorëzojë produktet e përcaktuara në kontratë gjegjesisht ne aneksin 1 dhe se, aplikimi i elementeve sekondare, konfirmon tendencën diskriminuese të Autoritetit Kontraktues, ndaj kompanis sonë.

Prandaj duke marrë parasysh kontradiktat thelbësore midis gjetjeve të ankuesit dhe pretendimeve të komisionit vlerësues të AK-së kërkojmë nga OSHP dhe zyrtaret përgjegjës te saje qe te autorizojne ekspert shqyrtues apo ekspert teknik i cili, para se të përpilojë raportin e tij të ekspertizës ne kuptim te nenit 113 dhe 114 te LPP-se te realizoj ekzaminim dhe matje fizike te mostrave te te dy operatoreve ekonomik te dorezuara ne AK, prandaj eksperti/ja, para dorezimit te raportit do duhej te ndermerrte këto veprime dhe të verifikojë fizikisht me instrumente të sakta matëse:

- Diametrin e saktë të bazës së dy mostrave,
- Gjerësinë reale të mbështetëses së shpinës tek pozicioni 2,
- Praninë e rrjetës anatomike në mbështetësen e kokës së mostrës së kompanis sonë “Galanteria” shpk dhe
- Mbushjen dhe cilësinë e mbështetëseve të duarve tek mostra e rekomanduar për kontratë.

Çdo vendimmarrje e bazuar vetëm në fotografitë e deformuara të vendimit të AK-së do të përbënte cenim të parimit të shqyrtimit dhe ekzaminimit administrativ dhe objektivitetit ligjor ku do te shkelej ne tërësi neni 105 dhe 113 i LPP-se, ne atë mënyrë qe Paneli Shqyrtues të nxjerre këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet,** si plotësisht e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik **"**Galanteria" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me nr 201-26-8482-5-5-8,- Lot 1.
II. **Anulohet, n**joftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 21.10.2026 për shpërblim me kontratë të OE "IBM" SH.P.K. për Lotin 1, si i kunderligjeshem dhe lënda kthehet në **Rivleresim.**
III. **Lejohet,** kthimi i tarifës së ankesës në shumen e deponuar ashtu siç percaktohet me nenin nenit 118 të LPP-së.

Në rast se eksperti shqyrtues i OSHP-së refuzon realizimin e matjes dhe ekzaminimin fizik të mostrave të të dy OE-ve dhe nxjerr raport vetëm mbi fotografitë fiktive të AK-së, kompania jonë, do të iniciojë ekspertizë të pavarur tekniko-forenzike përmes Institutit kompetent të Forenzikës, dhe të gjitha provat e matjeve reale së bashku me dosje do t'i përcjellim pranë Prokurorisë kompetente dhe Policisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike për dyshim të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe mashtrimit në prokurim publik.

Bashkëngjitur gjeni provat:

- Vendimi Nr. 23/2026 i AK-së i datës 29.10.2026;
- Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 21.10.2026;
- Kërkesa për Rishqyrtim e datës 26.10.2026 me provat fotografike krahasuese;
- Procesverbali i hapjes së ofertave i datës 12.10.2026;
- Pjesë relevante nga Dosja e Tenderit (Aneksi 1 – Specifikimet Teknike)
- Fotografit e mostrave te dorezuara ne AK nga OE ankues dhe OE i rekomanduar kunderligjeshem.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet materiale do te kalkulohen dhe do te kerkohet kompenzimi i tyre ne procedura tjera ne organet tjera.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*




B01
B01




B01

B01

B01






3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14







B01





B